




Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	08-06-2021	1	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinstva Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSKOC	2960/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.309/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.309/2021, të datës 27.04.2021, të parashtruara nga ankuesja ne adresë Rr. C, B.S Group, Hyrja D, Banesa 42, në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 07.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.309/2021 e datës 27.04.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 27.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2028/2021 të regjistruar me numër A.nr.309/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë për vitin 2018, 2019 dhe 2020, si dhe shtesa për kualifikimin shkollor, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 30.04.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Policia e Kosovës. Këshilli, me datë 14.05.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, për vendosje në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2028/2021 të regjistruar me numër A.nr.309/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin për punësim të datës 12.04.2021; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me N.Reference 07/1-01A/0705 për ankuesen; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës, të datës 27.06.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës, të datës 18.04.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës, të datës 11.03.2020; Diplomën e ankueses, të datës 30.09.2012; Ankesën e datës 16.04.2021 për Komisionin për Ankesa; Përgjigjen e datës 14.05.2021 nga Policia e Kosovës; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 30.06.2012; E-mailin informues të datës 14.04.2021; E-mailin e datës 22.04.2021 dhe 20.04.2021; Listën e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Kontratën e Punës me numër reference 07/1-01A/0705 të datës 13.08.2014, është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Përkthyes" në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës.

Ankuesja me datë 14.04.2021 ka parashtruar kërkesë në Drejtorinë e Personelit pranë Policisë së Kosovës, për kompensimin e shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë për vitin 2018, 2019 dhe 2020, si dhe shtesën për kualifikimin shkollor sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës, përmes përgjigjes me shkrim të datës 15.04.2021 ka njoftuar ankuesen se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën e saj të datës 14.04.2021. Pas kësaj përgjigje ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i njeh të drejtën e kompensimit të shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë dhe shtesës për kualifikim shkollor, dhe mbi këtë bazë i njëjti ka kërkuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, të aprovoje ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit për kompensimin e shtesave dhe beneficioneve për vitin 2018, 2019 dhe 2020, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku

përcaktohet se: ... 2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe benificione..., 3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Benificionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe benificionet e pensionit; 4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe benificionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtarët policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me datë 09.07.2020 ka nxjerr Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në piken 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativitetin të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj bazuar në këtë dhe duke i referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.309/2021

Aydyl BEKTESHI

Aydyl Bekteshi
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

